



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 17
Ndërtesa e Kuvendit, salla S - 1
Prishtinë, më 29 korrik 2015, në orën 10:30

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË
DHE MIRËQENIE SOCIALE

Në mbledhje morën pjesë: Flora Brovina, Fikrim Damka, Njomza Emini, Fadil Beka, Besa Baftiu, Time Kadrijaj dhe Shukrije Bytyçi.

Mungoi: Hatim Baxhaku dhe Adem Hoxha.

Stafi mbështetës i Komisionit: Shpresa Haxhijaj, koordinatore e Komisionit dhe Muhamet Bytyçi, zyrtar i fushës.

Mbledhjen e kryesoi, Flora Brovina, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

REND I DITËS:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës: 15.07.2015;
3. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror.
4. Të ndryshme.

Kryetarja e Komisionit, Flora Brovina konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 15.07.2015

Kryetarja, konstatoi se Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, miratoi procesverbalin e mbledhjes së Komisionit, të mbajtur më 15.07.2015, pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit të punës së Komisionit për sesionin pranveror;

Kryetarja – Të nderuar deputet sot në rend ditë kemi shqyrtimin e raportit të punës së komisionit për sesionin pranveror andaj në bazë të këtij raporti mund të vlerësojmë se sa e kemi përmbushur planin e punës së Komisionit, ti vlerësojmë cilat aktivitete i kemi përmbushur dhe cilat kanë mbetur për sesionin tjetër. Të gjitha mbledhjet e komisionit janë mbajtur, asnjë nuk është anuluar, kurse sa i përket shqyrtimit të projektligjeve fatkeqësisht kemi pas vetëm tri projektligje të cilat kanë ardhur nga Ministria e Shëndetësisë ku dy prej tyre i kemi përfunduar dhe kanë mbetur që të procedohen për miratim në seance, fatkeqësisht me vjen keq që edhe projektligji për shërbim mjekësor emergjent nuk e kemi përfunduar, por e përsëris se ishte një projektligj pak kaotik dhe problematik, ne do të kemi edhe shumë punë në sesionin e vjeshtës, për të punuar në të dhe kjo është arsyeja pse nuk është përfunduar. Aktivitetin e monitorimit të ligjit e kemi përfunduar, ne si komision kemi bërë monitorimin e Ligjit për Këshillin Ekonomiko-Social. Shqyrtimi i kërkesave të them të drejtën nuk kanë qenë të adresuar në mënyrë të rregullt apo kërkesat nuk kanë qenë të natyrës së komisionit. Mbajtja e dëgjimeve publike sipas meje kemi pas më shumë sesa që kemi planifikuar sepse ka ndodh që kemi mbajte dëgjime për tema ad hoc siç ishte dëgjimi për shëndetin oral e tjera. Vizitat brenda vendit kemi pas më shumë kërkesa që të vizitojmë institucione dhe vendbanime të shëndetit primar edhe të çështjeve që mbulojnë sektorin e çështjeve sociale, shtëpitë e pleqve, të hendikepuarëve etj. Kurse vizita jashtë vendit nuk u realizuan për çështje teknike, ajo që neve na pengoj është që nuk u përfundua projektligji për shërbimin mjekësor emergjent që do të na vyente neve një përvojë e tjerëve dhe një diskutim ose debat mes palëve në Shqipëri dhe Mal të Zi, por nuk ishte faj jonë ne e dorëzuam kërkesën me kohë dhe besoj që në sesioni e vjeshtës mbasi e kemi ende në shqyrtim këtë projektligj është mirë që ta realizojmë këtë vizitë. Raportimi i ministrave në komision sipas meje mendoj që ministrat i janë përgjigjur ftesave tona sa herë i kemi ftuar. Vërejtja ime ka qenë që këto takime tona nuk janë përcjellë në mënyrë të rregullt nga mediat dhe puna jonë nuk është parë sa duhet në media.

Mendoj se komisioni ka mundur me qenë edhe me aktiv, sikur të kishim pas edhe më shumë projektligje të sponsorizuara nga qeveria, mendoj që do të ndodh në sesionin vjeshtor, duhet të mobilizohemi. Një ndër çështjet që duhet që ta marrim përsipër është zbatimi i ligjit për skemat pensionale të financuara nga shteti sepse dihet që skemat pensionale është dashtë të filloj me u implementu.

Shukrije Bytyçi - Faleminderit kryetare, përshëndetje për të gjithë kolegët dhe përfaqësuesit e mediave. Mendoj që komisioni për shëndetësi ka bërë një punë të mirë, ndoshta kemi mundur të bëjmë edhe më tepër, konkretisht ne kemi bërë një monitorim dhe e ka pas efektin e vet. Javën e kaluar ne si bord drejtues i grave kemi vizituar shoqatën e të verbërve dhe ata patën vërejtje të mos implementimi i ligjit për të verbrit, fatmirësisht kanë një ligj dhe kanë mbrojtje ligjore por mjerisht kategoritë e tjera nuk kanë mbrojtje ligjore mendoj që ne në sesionin vjeshtor ta kemi parasysh, ne e kemi pas projektligjin për paraplegjikët por u tërheq më kërkesën e ministrit për shkak se do ta bëjnë një ligj për të gjitha kategoritë me aftësi të kufizuara. Mendoj që nuk është bërë punë e mirë edhe të ligji për arsim mbasi i takoj asaj fushe i kemi pas tre nxënës të verbër në testin e maturës shtetërore edhe nuk kanë qenë në gjendje me ju sigurue testin me alfabet të brailit, të çështja e punësimit pavarësisht se disa kanë arrit të kenë një profesion janë të diskriminuar në çështje të punësimit ne e kemi vizituar shoqatën e Handikosit në disa komuna kryesore, jam befasuar për të mirë nga një jurist por mjerisht ai nuk është duke punuar askund. Kështu që kërkojmë për sesionin vjeshtor ti tejkalojmë këto probleme teknike dhe të vizitojmë institucionet më tepër veçanërisht kategoritë më aftësi të kufizuara. Të çështja e përvojave për projektligjet pajtohem se na duhet një përvojë e shteteve më përvojë më të avancuar.

Besa Baftiu - Faleminderit kryetare, përshëndetje për të gjithë, mendoj që në këtë raport sa e pashë janë të paraqitura të gjitha aktivitetet dhe puna e komisionit në mënyrë shumë të mirë. Në përgjithësi është një raport i paraqitur në mënyrë të detajuar, ndërsa sa i përket punës se e ka mundur që komisioni me bërë më tepër, pajtohem me vërejtjet e kryetares dhe koleges Shukrije. Sa i përket vizitave në institucione duke pas parasysh se komisioni jonë merret me sektorët e veçantë si shëndetësi apo edhe çështjeve sociale kemi mundur që ti vizitojmë këto kategori apo këtë grup të njerëzve që së paku ti qajnë hallet me ne, dhe ti marrim parasysh vërejtjet e tyre dhe ti adresojmë aty ku duhet. Mos të hyjmë në detaje për projektligjet tri na kanë ardhur, dy projektligje janë përfunduar ndërsa projektligji për shërbimin mjekësor emergjent kemi kërkuar që të tërhiqet ky projektligj nga Qeveria se kemi pas vërejtje nga vet ne, ku shumica më duket nuk e kemi votuar në Kuvend edhe pse e kemi dhënë lejen me procedu në lexim të parë, kështu mendoj se kjo ka qenë një vonesë se ne nuk jemi marrë shumë më këtë projektligj se kemi desh ti shohim praktikën e vendeve tjera mendoj se kjo ka qenë arsyeja që nuk kemi mund me përfundu këtë projektligj. Mediat kanë qenë të pranishme vetëm kur kemi pas të ftuar nga ministria ose nga inspektorati i punës apo grupe të interesit, kanë ardhur në fillim mandej kanë dal, ndërsa sa i përket në mbledhje të tjera të komisionit ato nuk kanë qenë prezent.

Kryetarja – Ajo është e drejtë e secilit anëtar, pajtohem që edhe në vizita vendore kemi mundur me qenë më aktiv, dhe është e nevojshme ta rregullojmë planin e punës në sesionin vjeshtor, që gjatë sesionit vjeshtor të fillojmë një debat për zbatimin e ligjit të punës.

Time Kadrijaj - Faleminderit kryetare, e falënderoj stafin mbështetës për punë që po e bëjnë në vazhdimësi. Mendoj që pak projektligje kanë kaluar përmes komisionit tonë, nuk është faji i komisionit por i Qeverisë që nuk ka proceduar më shumë, në fakt prej tri projektligjeve dy i kemi përfunduar. Kanë ardhur shumë me vonesë nga Qeveria. Unë konsideroj se nuk kemi pasur një bashkëpunim të mirë me ministrinë që i mbikëqyrim përpos vetëm ftesave që i kemi ftuar për raportim ministrave, ndërsa sa i përket organizimit të ndonjë tryeze për diskutime të ndryshme kemi ngecur. Kemi pasur organizime të ndryshme nga Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, ku shpesh here e kemi ngritë këtë çështje në komision për anashkalimin e komisionit parlamentar ne nuk kemi pas ftesa nga këto ministri për pjesëmarrje në këto aktivitete të tyre. Kemi qenë të anashkaluar nga këto ministri përpos ardhjes së ministrave për raportim që edhe e kanë obligim ligjor. Sa i përket vizitave studimore më duket që jemi komisioni i vetëm në Kuvend që nuk kemi lëvizur në asnjë vizitë. Shpresoj që në sesionin vjeshtor do të jemi më aktiv, do të realizojmë një vizitë studimore, do ti caktojmë prioritetet.

Njomza Emini - Faleminderit kryetare, pa dashur ti përsëris ato që i thanë kolegët që pajtohem plotësisht, po të falënderoj ty kryetare për komunikimin e rregullt edhe anëtarët e tjerë mendoj që kemi bashkëpunuar mirë për këtë periudhë. Sa i përket raportit i falënderoj stafin mbështetës të komisionit ku përveç raportit kanë qenë edhe korrekt edhe në adresimin e çështjeve sa herë që unë si anëtare e komisionit që kam kërkuar. Të kjo pjesa ku kemi ngec pa fajin tonë realizimi i vizitave jashtë vendit, kryetarja ka bërë kërkesë më kohë e cila është mbështetur edhe nga Kryesia e Kuvendit mirëpo për shkak të rrethanave nuk kemi mundur ti realizojmë vizitat për shkak të zgjedhjeve që ishin në Shqipëri po ashtu edhe unë kur kam qenë në vizite zyrtare në Bundestagun Gjerman kam bërë kërkesë që të takohemi me komisionin për shëndetësi të cilët e kanë mirëpritur mirëpo ende nuk kemi një përgjigjeje zyrtare nga ta. Ndërsa për projektligjet mendoj që është normale momentin që nuk ka projektligje nuk mundesh edhe me qenë aktiv kjo është zingjirorë. Kurse të çështja e mediave është e vërtet se puna e komisionit nuk është prezantuar sa duhet nëpër media unë konsideroj se duhet trajtuar në sesionin e ardhshëm edhe këtë problematike.

Kryetarja - Komisioni ka qenë i njoftuar po ashtu edhe stafi mbështetës i komisionit për të gjitha takimet ku edhe ka marrë pjesë në këto takime të cilat kanë qenë me ambasador dhe organizata ndërkombëtare të cilat kane shprehur gatishmërinë për bashkëpunim. Edhe me OSBE-në dhe me OBSH-në kemi realizuar takim ku jemi zotuar për një bashkëpunim të ngushtë. Sa i përket ftesave nga Ministritë për aktivitetet e tyre ne kemi pas disa ftesa prej ministrisë së shëndetësisë mirëpo për shkak se ka qenë ditën kur kemi pasur edhe seance s'kemi mujte që të marrim pjesë megjithatë pajtohemi me Timen se ata mund të na ftojnë më shpesh. Kjo nuk i pengon punës tonë por duhet thellojmë bashkëpunimin ndërmjet veti. Ndoshta një vërejtje personalisht së pari për mua mandej edhe për ju të gjithë, në lidhje me buxhetin ne kemi mundur si komision me qenë më aktiv, ta shqyrtojmë ndryshe buxhetin dhe të japim vërejtjet tona por buxheti, ndoshta nuk kemi pas shumë mundësi ndërhyrjeje në këtë buxhet, mandej me dal me një pikëpamje të përbashkët si komision, sepse nga buxheti varet zbatimi i planeve dhe synimeve që i kanë ministritë dhe ne si komision.

Fadil Beka - Faleminderit kryetare, përshëndetje për të gjithë, e falënderoj stafin mbështetës për punë që po e bëjnë në vazhdimësi. Pajtohemi edhe unë me gjithë ato që u thanë. Unë jam deputet për herë të parë në parlament dhe anëtar i këtij komisioni kam qenë shumë i kënaqur me kolegialitetin, sepse të gjithë kemi qenë të vetëdijshëm për sensitivitetin e çështjeve për të cilat merret ky komision, qëndrimet kanë qenë shumë konstruktive kisha pas dëshirë që në sesionin vjeshtor me qenë më aktiv, me shprehës se do të vijmë më shumë projektligje, më e rëndësishme me e ruajt kolegialitetin dhe konstruktivitetin dhe rezultatet nuk do të mungojnë.

Kryetarja – Me lejon krejt në fund që edhe unë të falënderoj stafin mbështetës, që kanë qenë profesional, korrekt në punë dhe shumë efikas në punën e tyre. Besoj se kështu do të jenë edhe në sesionin e ardhshëm. Nuk peshohet vetëm me mbledhje puna e komisionit dhe sa konflikte në një komision por edhe në afrimin dhe ndërtimin e dialogut të brendshëm. Edhe pjesëmarrja e anëtareve në grupe punuese është ndryshe nga përvoja ime. Shumë grupe punuese formohen me dy apo tre anëtar por të komisioni jonë të gjithë anëtarët kanë shpreh dëshirën më qenë në grupe punuese dhe kjo është për tu lavdëruar se ka sjell rezultat.

Komisioni pasi shqyrtimit miratoj njëzëri raportin e punës së komisionit për sesionin pranveror.

4. Të ndryshme

Besa Baftiu - Faleminderit kryetare, një çështje dua të ngriti në komision, ashtu siç tha kryetarja se çështjet që diskutohen në komision dhe dalim bashkërisht me një përfundim dhe i paraqesim në seancë atëherë më siguri se ministritë përkatëse atëherë do të merret me më seriozitet sepse është ngrit nga komisioni dhe nuk është ngrit vetëm nga opozita por edhe nga deputetet e pozitës. Çështja të cilën dëshiroj të ngriti është çështja që ka të bëjë me specialistët të cilët janë duke e kryer specializimin beso që ka specialist që diku i bënë 360 ore në muaj punë, duke marrë parasysh se punon edhe në shtëpi të shëndetit por edhe në specializim, këto të dhëna i kam në detaje që mi kanë dërguar specialistet, fillimisht kanë menduar se gjejnë mbështetje të ministri janë takuar në fillim kur e ka marrë mandatin ministri i ri, mandej kanë protestuar, kanë dal edhe në media. Janë 291 specialistë dhe këta nuk marrin pagë ose një pjesë e tyre merr por i mban dy orare të punës. Është ngrit disa herë por ministri ka thënë se nuk ka mjete buxhetore, por nuk është ashtu por me siguri kur janë kategorizuar janë bërë dallavere gjatë ndarjes, e ceka edhe atë ditë se ministri i tanishëm nuk është ndoshta fajtor se këto janë ndarë në mandatin e kaluar dhe janë ndarë para fushatës dhe janë bërë manipulime, besoj që duhet me ju dalë në ndihmë pasi që jemi të thirrur për trajtimin e çështjeve që kanë të bëjnë me shëndetësi.

Kryetarja - Le të jetë kjo temë e një debati me të gjerë, ku do të ishte ministri i shëndetësisë dhe nga ky debat do të vijmë në përfundim pastaj në emër të komisionit do të dalim më një qëndrim në Kuvend. Ndoshta ndonjëherë edhe vet specialistët nuk e kuptojnë se nuk paguhet specializimi se edhe mua para 25 viteve askush nuk ma ka paguar askush, por puna ku kam qenë e punësuar ata ma kanë paguar një pjesë kjo është si rregull, edhe unë aty kam punuar tërë ditën ama nuk jam paguar. Duhet të interesohemi për funksionimin e odave të profesionistëve shëndetësor, se ku qëndron problemi pse ende nuk janë funksionalizuar.

Fikrim Damka – Funksionimi i Odave po ka telashe, tek tash kanë arrit të themelohen të gjitha Odat që parashihen me ligj, kurse funksionalizimi i tyre dhe marrja e përgjegjësisë që ju takojnë me ligje ka ngecje dhe telashe të shumta edhe buxhetore, ne në të ardhmen duhet trajtuar edhe këtë çështje me seriozisht.

Kryetarja - Nëse nuk keni asgjë tjetër, ju falënderoj dhe ju uroj pushim të këndshëm.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20

E përqatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Flora BROVINA